

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6318
E shtunë, 22 maj 2021
çmimi 0.40 €

Qeveria emëron bordet e përkohshme të drejtorëve në katër ndërmarrje publike

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

USHTRUESI I DETYRËS I KRYETARIT TË ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË UÇK-SË, FATON KLINAKU, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

FAQE 4-5

KLINAKU: NË SPECIALE PO QËNDROJNË TË PAFAJSHËM PJESËTARËT E UÇK-së PËRBALLË NJË PROKURORIE QË KA MBUSHUR THASËT ME PROPAGANDË



Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, në një konferencë për media mbajtur të premtën, ka thënë se në muajt dhe ditët e fundit jemi dëshmitarë të shtimit të retorikës urrejtëse në diskursin publik kundër pjesëtarëve të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës. Në këtë drejtim, Klinaku ka drejtuar akuza edhe në adresë të kryeministrit Albin Kurti dhe ministres së Jashtme Donika Gërvalla. "U bëjmë thirrje krerëve shtetërorë të japin sqarime për deklaratat e tyre, e posaçërisht konkretisht Albin Kurtit. Askush të mos testojë

më tutje durimin e ushtarëve të lirisë", është shprehur Klinaku. Ai ka thënë se në Gjykatën Speciale po qëndrojnë kot dhe tërësisht të pafajshëm pjesëtarë të UÇK-së përballë një prokurorie që ka mbushur thasët me propagandë nga retorika 20-vjeçare e Serbisë dhe argatëve të saj shqipfolës

AKTUALE



AVOKATURA SHETËRORE FITOI 516 RASTE GJYQËSORE, BUXHETI PËRFITOI GATI 13 MILIONË EURO

F. 10

SHËNOHET 109-VJETORI I KUVENDIT TË JUNIKUT

F. 10

QEVERIA KURTI HESHT LIDHUR ME MANASTIRIN E DEÇANIT

F. 6



EKONOMI

FILLOI PUNA PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR KONFISKIMIN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË PAJUSTIFIKUESHME

F. 9

SPORT

DUKAGJINI NË FINALE TË BARAZHIT

F. 12



QINDRA QYTETARË NËN SHKRUAN PETICIONIN PËR LIGJIN PËR FALJEN E BORXHEVE TË PANDEMISË

FAQE 3



PDK-ja REFUZON FTESËN E KURTIT, LDK-ja E AAK-ja SHKOJNË NË TAKIM

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shefi i inteligjencës britanike paralajmëron për rreziqet e ekstremizmit online

LONDËR, 21 MAJ - Për sigurinë kombëtare britanike, ekstremizmi në mediat sociale paraqet rrezik po aq sa terrorizmi nga Afganistani ose Siria, ka paralajmëruar kreu i Agjencisë së Inteligjencës në Mbretërinë e Bashkuar. "Terroristët me vetiniciativë", apo siç njihen ndryshe "ujqërit e vetmuar", mbeten një kërcënim më i madh sesa komplotet e kategorisë së 11 shtatorit ose sulmet "7/7" të korrikut 2005 në Londër. Kështu ka thënë shefi i Shërbimit të Inteligjencës MI5, Ken McCallum, në një

intervistë për "Times Radio". Sipas tij, vetëm në katër vjetët e fundit, MI5 dhe komanda e Policisë Metropolitane e Londrës kundër terrorizmit kanë shkatërruar 29 komplete të cilat ishin në fazat e fundit, përfshirë 10 nga ekstremistët e bardhë të ekstremit të djathtë. "Të dyshuarit kanë qenë kryesisht ata që janë radikalizuar online dhe në mesin e tyre ka pasur edhe të moshës 13-vjeçare", ka thënë ai.

Ai ka kritikuar në veçanti "Facebook"-un për rregullat e enkriptimit duke thënë se

"vendimet që merren në sallat e bordeve të Kalifornisë janë gjithnjë e më shumë të rëndësishme për aftësinë tonë për t'i bërë punët tona sikurse vendimet e marra në Afganistan ose Siri". "Kjo përbën një rrezik real për ne. Puna jonë është që, për shembull, të merremi me një në një milion rast, ku dhoma e ndenjes është një dhomë e gjallë terroriste. Ata mund të jenë duke prodhuar një bombë, ose duke filmuar një video para komplotit shkatërrues që mund të jetë duke planifikuar", ka deklaruar



McCallum. Megjithatë, ai ka theksuar se pajtohet me dëshirën e shefit të "Facebook"-ut për ta "mbrojtur privatësinë".

"Absolutisht ne nuk duam të jetojmë në një shoqëri ku shteti ka një aparat fotografik në dhomën e ndenjes së të gjithëve", ka deklaruar ai.

Hungaria iu thotë lamtumirë maskave



BUDAPEST, 21 MAJ - Hungaria do ta heqë shumicën e kufizimeve ndaj pandemisë, duke përfshirë masën e izolimit gjatë orëve të natës, sapo që numri i të vaksinuarve të arrijë 5 milionë këtë fundjavë, tha të premten kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban. Orban i tha radios shtetërore se nuk do të ketë më nevojë që banorët të mbajnë maska në ambiente të hapura. "Kjo do të thotë që ne kemi

mundur valën e tretë të pandemisë", ka thënë Orban, duke shtuar se ka ardhur koha për t'u thënë "lamtumirë maskave" në vendet publike. Hungaria është i vetmi vend i Bashkimit Evropian që ka miratuar dhe përdorur vaksinën Sputnik të Rusisë dhe ato kineze. Kjo i ka mundësuar këtij vendi që të arrijë një nga nivelet më të larta të vaksinimit në BE. Rreth 50 për qind e popullsisë prej rreth 10 milionësh,

tashmë kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës. Shumica e bizneseve tashmë janë hapur, duke përfshirë hotelet, restorantet, pastaj teatrot, kinematë, palestrat dhe vendet e tjera sportive. Vitin e kaluar ekonomia e këtij vendi u tkurr për 5 për qind. Kryeministri Orban ka thënë se rritja ekonomike këtë vit pritet të jetë më e lartë se parashikimi aktual i qeverisë prej 4.3-përqindësh.

Bidenit i kërkohet ta rishikojë vendimin për gazsjellësin rus

UASHINGTON, 21 MAJ - Disa ligjvënës amerikanë i kanë kërkuar presidentit Joe Biden ta rishqyrtojë vendimin e tij për të hequr dorë nga disa sanksione në lidhje me gazsjellësin Rrjedha Veriore 2 midis Rusisë dhe Gjermanisë. Ligjvënësit kanë argumentuar se masa është kundër "interesave të sigurisë kombëtare dhe transatlantike të ShBA-së". "Ne besojmë fuqimisht se është në interesin kombëtar të ShBA-së mbrojtja e sovranitetit të Ukrainës dhe mbrojtja e Evropës Lindore nga agresioni rus", thanë në një deklaratë të përbashkët,

ligjvënësit Marcy Kaptur, Andy Harris, Mike Quigley dhe Brian Fitzpatrick.

Administrata e presidentit Biden më 19 maj sanksionoi disa kompani dhe anije për punën e tyre në projektin Rrjedha Veriore 2, por hoqi dorë nga ndëshkimet për kompaninë që merret me ndërtimin dhe shefin ekzekutiv të saj, Matthias Warnig.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se masa ishte "në përputhje me angazhimin për t'i forcuar marrëdhëniet transatlantike si një çështje e sigurisë



kombëtare". Ai, gjithashtu, ka thënë se administrata amerikane do të "vazhdojë ta kundërshtojë përfundimin" e

projektit prej 12 miliardë dollarësh. Vendimi për të mos sanksionuar Rrjedha Veriore 2

- një filial i Gazpromit rus dhe Warnig, zemëroi shumë ligjvënës demokratë dhe republikanë, por u përshëndet nga Kremli dhe Berlina. Rrjedha Veriore 2 është përfunduar rreth 95 për qind dhe i gjithë projekti mund të përfundojë deri në shtator. Gazsjellësi ka qenë një pikë grindjeje midis Berlinit dhe Uashingtonit. Ky tubacion parashihet se do të transportojë 55 miliardë metra kub gaz natyror çdo vit direkt nga Rusia në Gjermani. Ai, gjithashtu, do ta anashkalojë Ukrainën, një vend aleat i Perëndimit.

Izraeli dhe Hamasi pajtohen për armëpushim

JERUSALEM, 21 MAJ - Qeveria e Izraelit ka konfirmuar miratimin e vendimit për një armëpushim në Gaza. Në deklaratën e saj nuk njoftohet për kohën kur do të hyjë në fuqi armëpushimi. Qeveria izraelite thotë se armëpushimi u propozua nga Egjipti dhe do të jetë "i

pakushtëzuar". Një zyrtar i grupit militant Hamas i tha agjencisë "Reuters" se Izraeli dhe Hamasi do ta fillojnë armëpushimin "e ndërsjellë dhe të njëkohshëm" të premtën në orën 2:00 të mëngjesit.

Si Izraeli ashtu edhe Hamasi janë përballur me presion

ndërkombëtar për t'u dhënë fund luftimeve. Të enjten më shumë se 100 sulme ajrore izraelite shënjestruan infrastrukturën e Hamasit në veri të Gazës. Hamasi u hakmor duke shkrepur raketa në drejtim të Izraelit. Luftimet në Gaza filluan më 10 maj pas disa javësh të rritjes së

tensioneve izraelito-palestineze në Jerusalem. Grupi militant Hamas, të cilin Izraeli, BE-ja dhe ShBA-ja e konsiderojnë terrorist, filloi të qëllonte me raketa, duke shkaktuar sulme ajrore hakmarrëse nga forcat



izraelite. Gjatë 11 ditëve të luftimeve janë vrarë të paktën 232 persona në Gaza dhe 12 në Izrael.

Kurti kërkon nga ministrat që të punojnë në agjendën e integrimit evropian

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë të premtën në mbledhjen e parë të Këshillit Ministror për Integrim Evropian të Qeverisë së Kosovës. Në fjalën e hapjes, kryeministri Kurti ka thënë se Këshilli Ministror për Integrim Evropian është themeluar si strukturë koordinuese ndër-institucionale, që do të shërbejë si forum i fokusuar për të diskutuar për reformat e rëndësishme, që kërkojnë qasje dhe bashkëpunim ndër-institucional, vëmendje dhe drejtim politik.

Një nga përfitimet direkte të të qenit në proces të integrimit në Bashkimin Evropian, siç tha kryeministri, është edhe

skanimi dhe pasqyrimi i punës që na bëhet nga Bashkimi Evropian, në secilën fushë e për çdo vit. "Kjo, në fakt, e lehtëson shumë punën tonë, por edhe punën time, sepse e kam më të lehtë ta shoh progresin dhe të kërkoj përgjegjësi nga secili prej jush aty ku ka dështime e vonesa", ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se pret që kërkesat dhe kriteret që dalin nga procesi i integrimit në Bashkimin Evropian për vendin tonë, në kuptimin e standardeve që duhen arritur dhe plotësuar, të trajtohen me seriozitetin e duhur dhe me përkushtimin e nevojshëm. "Në aspiratat tona shtetërore për të qenë një shtet i zhvilluar, me ekonomi të qëndrueshme dhe vend demokratik ku sundojnë ligji dhe drejtësia, standardet e

Bashkimit Evropian duhet të jenë udhërrëfyes", është shprehur kryeministri Kurti, duke shtuar se agjendën e integrimit evropian duhet ta shohim si pjesë integruese e agjendës qeveritare dhe shtetërore. "Ne nuk duhet ta shohim procesin e integrimit evropian nga distanca, si qëllim më vete, si detyra që BE-ja na ka caktuar e të cilat duhet t'i arrijmë ashtu që në fund të shpërblehemi. Përkundrazi, duhet ta shohim si një mundësi që ne e kemi për t'u reformuar, për t'u zhvilluar dhe për ta arritur standardin demokratik, ekonomik dhe mirëqenien tonë. Pronësia e reformave që kërkojnë mbetet te ne dhe ne duhet të veprojmë në përputhje me përgjegjësitë që kemi marrë. Përmesja e shumë kriterëve

dhe standardeve varet nga vullneti dhe përkushtimi ynë për t'i kryer ato. Qeveria jonë ka këtë vullnet dhe përkushtim dhe do të angazhohemi fuqishëm që ta materializojmë atë", ka deklaruar Kurti.

Ai ka shtuar se një nga përfitimet direkte të të qenit në proces të integrimit në Bashkimin Evropian është edhe skanimi dhe pasqyrimi i punës që u bëhet institucioneve të Kosovës nga Bashkimi Evropian, në secilën fushë e për çdo vit. "Kjo, në fakt, e lehtëson shumë punën tonë, por edhe punën time, sepse e kam më të lehtë ta shoh progresin dhe të kërkoj përgjegjësi nga secili prej jush aty ku ka dështime dhe vonesa", ka thënë Kurti. Kryeministri Kurti ka kërkuar përgjegjësi nga ministrat për

reformat integruese. "Pra do të kërkoj përgjegjësi nga ministrat për reformat konkrete që duhen të udhëhiqen dhe zbatohen, por edhe nga të gjithë zyrtarët publikë në pajtim me mandatin dhe përgjegjësinë e secilit. Për këtë qëllim, agjenda e integrimit evropian duhet të jetë e mishëruar në planet e punës të secilit institucion dhe zyrtar në institucionet tona", është shprehur kryeministri Kurti.

Në mbledhjen e parë të Këshillit Ministror për Integrim Evropian të Qeverisë së Kosovës, u shqyrtua plani i veprimit për fazën e dytë të prioritetëve politike në kuadër të procesit të integrimit evropian (përkatësisht Agjendës së Reformave Evropiane - ERA II).



Qindra qytetarë nënshkruan petitionin për faljen e borxheve të pandemisë

EPOKA ERE Qendresa RAMA

Prishtinë, 21 maj - Të premtën në sheshin "Zahir Pajaziti" ka filluar mbledhja e nënshkrimeve për petitionin qytetar për faljen e gjobave të pandemisë Covid-19. Ky petition është organizuar nga Partia Socialdemokrate (PSD).

Qindra qytetarë të premtën kanë nënshkruar petitionin për ta dërguar ligjin për faljen e borxheve në Kuvend. Përmes mbledhjes së nënshkrimeve do të kërkoj anulimi i këtyre gjobave për periudhën 15 mars 2020 - 15 maj 2021.

Pandemia dhe masat e mbylljes tashmë i kanë

kushtuar shumë ekonomisë së vendit tonë. Deri tash janë shqiptuar mbi 180 mijë gjoba, kurse gjoba më e vogël është 35 euro. Pagesat e gjobave përbëjnë heqje të parasë nga qarkullimi dhe ulje të kërkesës agregate, sepse shumica e gjobave të shqiptuara janë ndaj qytetarëve të varfër ose të shtresës së mesme.



USHTRUESI I DETYRËS I KRYETARIT TË ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË UÇK-SË,
FATON KLINAKU, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

Klinaku: Në Speciale po qëndrojnë të pafajshëm pjesëtarët e UÇK-së përballë një prokurorie që ka mbushur thasët me propagandë

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, në një konferencë për media mbajtur të premten, ka thënë se në muajt dhe ditët e fundit jemi dëshmitarë të shtimit të retorikës urrejtëse në diskursin publik kundër pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë drejtim, Klinaku ka drejtuar akuza edhe në adresë të kryeministrit Albin Kurti dhe ministres së Jashtme Donika Gërvalla. “U bëjmë thirrje krerëve shtetërorë të japin sqarime për deklaratat e tyre, e posaçërisht konkretisht Albin Kurtit. Askush të mos testojë më tutje durimin e ushtarëve të lirisë”, është shprehur Klinaku. Ai ka thënë se në Gjykatën Speciale po qëndrojnë kot dhe tërësisht të pafajshëm pjesëtarët e UÇK-së përballë një prokurorie që ka mbushur thasët me propagandë nga retorika 20-vjeçare e Serbisë dhe argatëve të saj shqipfolës



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 MAJ - Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë të premten se në muajt dhe ditët e fundit jemi dëshmitarë të shtimit të retorikës urrejtëse në diskursin publik kundër pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “Për fat të keq, që një kohë të gjatë në nivelin shtetëror kjo retorikë ose i barazon në një nivel UÇK-në dhe kriminelët serbë, ose po shkon drejt shfajësimit të Serbisë për

luftërat e fundit kundër kombeve fqinje, ose fjalimeve që akuzojnë e fajësojnë drejtpërdrejt më shumë UÇK-në sesa shtetin serb për krimet e luftës”, ka thënë Klinaku në një konferencë për media, ku po këtë ditë u pre edhe një tortë në zyrat e OVLUÇK-së me rastin e ditëlindjes së nënkryetarit të OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, i cili ndodhet në paraburgim në Hagë. Klinku në këtë drejtim ka drejtuar akuza në drejtim të kryeministrit Albin Kurti dhe ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla. “Një ministreshë në

Kuvendin e Kosovës, me shumë urrejtje tha se ‘Serbia nuk ka faj, por ju’ për krijimin e Gjykatës Speciale. Në rrjetet sociale dhe në mediat e pushtetit u shtuan sulmet dhe urrejtjet ndaj nesh. Por, ajo që nuk pritej ndodhi në darkën e Brukselit. Disa e quajnë darkë e turpit e disa darkë e zezë. Ne fillimisht e pamë si darkë dhe takim të zakonshëm të liderëve të Ballkanit Perëndimor. Pas saj, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, krimet dhe kriminelët që janë identiteti i Serbisë gjenocidale, i shpërndau nëpër tërë Ballkanin Perëndimor, duke ia lehtësuar barrën Serbisë. Ka ende kriminelë, tha ai, në pushtet dhe institucione në Ballkanin Perëndimor. Kriminelët duhet të eliminohen dhe prania e tyre në pushtet dhe institucione shtetërore duhet të marrë fund, tha ai. Në kontekstin e darkës, kjo sikur u nënkuptua se po aludon diçka për Serbinë, por vetë darka me udhëheqësen e qeverisë serbe aty, i bën disi të çuditshme deklaratat: ha me të dhe akuzo. Të tjerët menduan se po i referohet kryetarit të saj që pritej, por nuk shkoi në darkë. Kuptimet dhe nënkuptimet zbritën edhe në Kosovë e në drejtim të UÇK-së”, ka deklaruar Klinaku.

Klinku gjatë kësaj konference ka parashtruar edhe pyetje: “Për kënd e ka fjalën saktësisht kryeministri Kurti kur deklarohet për eliminimin e kriminelëve në Ballkanin Perëndimor?”. “Ua përkujtojmë të gjithëve se në Gjykatën Speciale po qëndrojnë kot dhe

tërësisht të pafajshëm pjesëtarët e UÇK-së përballë një prokurorie që ka mbushur thasët me propagandë nga retorika 20-vjeçare e Serbisë dhe argatëve të saj shqipfolës”, ka deklaruar u. d. kryetari i OVLUÇK-së, Faton Klinaku. Ai ka shtuar se ushtria jonë çlirimtare njihet për pastërtinë maksimale në veprimet luftarake dhe në përputhje me konventat e luftës. “Për këtë ka arsye të mburret tërë kombi dhe miqtë tanë dhe jo të turpërohet për diçka. U bëjmë thirrje krerëve shtetërorë të japin sqarime për deklaratat e tyre, e posaçërisht konkretisht Albin Kurtit, sepse një spastrim i padrejtë tashmë është në vepër nga dora e tij dhe aleatëve të tij politikë. Askush të mos testojë më tutje durimin e ushtarëve të lirisë”, ka thënë Klinaku.

Deklarata e plotë (pa ndërhyrje) e ushtruesit të detyrës të kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku:

Në muajt dhe ditët e fundit jemi dëshmitarë të intensifikimit të retorikës urrejtëse në diskursin publik kundër pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për fat të keq, që një kohë të gjatë, në nivelin shtetëror kjo retorikë ose i barazon në një nivel UÇK-në dhe kriminelët serbë, ose po

shkon drejt shfajësimit të Serbisë për luftërat e fundit kundër kombeve fqinje, ose fjalimeve që akuzojnë e fajësojnë drejtpërdrejt më shumë UÇK-në sesa shtetin serb për krimet e luftës.

Një ministreshë në Kuvendin e Kosovës, me shumë urrejtje tha se “Serbia nuk ka faj, por ju” për krijimin e Gjykatës Speciale. Në rrjetet sociale dhe në mediat e pushtetit u shtuan sulmet dhe urrejtjet ndaj nesh.

Por, ajo që nuk pritej, ndodhi në darkën e Brukselit. Disa e quajnë darkë e turpit e disa darkë e zezë. Ne fillimisht e pamë si darkë dhe takim të zakonshëm të liderëve të Ballkanit Perëndimor. Pas saj, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, krimet dhe kriminelët që janë identiteti i Serbisë gjenocidale, i shpërndau nëpër tërë Ballkanin Perëndimor, duke ia lehtësuar barrën Serbisë. Ka ende kriminelë, tha ai, në pushtet dhe institucione në Ballkanin Perëndimor. Kriminelët duhet të eliminohen dhe prania e tyre në pushtet dhe institucione shtetërore duhet të marrin fund, tha ai. Në kontekstin e darkës, kjo u sikur u nënkuptua se po aludon diçka për Serbinë, por vetë darka me udhëheqësen e qeverisë serbe aty, i bën disi të çuditshme deklaratat: ha me të dhe akuzo. Të tjerët menduan se po i referohet kryetarit të saj, që pritej por nuk shkoi në darkë. Kuptimet dhe nënkuptimet zbritën edhe në Kosovë e në drejtim të UÇK-së. Dy ditë më parë filloi një eliminim i ri i



OVLUÇK-ja ia feston ditëlindjen Nasim Haradinajt

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Nasim Haradinaj, ka mbushur 58 vjet të premten. Haradinaj ndodhet në qendrën e paraburgimit në Hagë bashkë me kryetarin e kësaj organizate, Hysni Gucati dhe disa bashkëluftëtarë të tjerë. Por OVLUÇK-ja ka zgjedhur që ditëlindjen e tij ta festojë në Prishtinë. Për nder të tij është prerë edhe një tortë dhe është organizuar një festë në zyrat e kësaj organizate.

krerëve ose protagonistëve kryesorë të UÇK-së nga diplomacia, ku u përfshi sërish ministresha që shfaqësoi Serbinë në Kuvendin e Kosovës dhe bashkëpartiakja e saj, kryetarja e shtetit.

Tani jemi këtu për të sqaruar këtë fushatë konkrete që po nis nga retorika e tyre urrejtëse kundër UÇK-së drejt veprimeve e kërcënimeve të përditshme që po e bëjnë gjithnjë më të rëndë jetën e ushtarëve të lirisë.

Për kënd e ka fjalën saktësisht kryeministri Kurti kur deklarohet për eliminimin e kriminelëve në Ballkanin Perëndimor?

Në darkën e Brukselit apo në darkën e turpit merrnin pjesë përfaqësues nga shtetet që nuk kanë luftuar me Serbinë, si Shqipëria, Mali i Zi e Maqedonia. Aty ishte edhe Kosova që ka bërë luftë çlirimtare, sikurse ka bërë Bosnja e mbytyr në gjak dhe Kroacia poashtu. Kush janë, prandaj, kriminelët e ballkanit perëndimor kur vetë Kurti nuk i emëron saktë? Ne dimë dhe tërë bota e dimë se Serbia është e mbushur me të kriminelë dhe nxënës të Millosheviqit dhe jo shtetet që i ka sulmuar Serbia.

Ua përkujtojmë të gjithëve se në Gjykatën Speciale po qëndrojnë kot dhe tërësisht të pafajshëm pjesëtarë të UÇK-së përballë një Prokurorie që ka mbushë thasët me propagandë nga retorika 20-vjeçare e Serbisë dhe argatëve të saj shqipfolës. Prokurorët tashmë e dinë se do të dështojnë me turp dhe bashkë me ta të gjithë ata që me retorikën urrejtëse kundër UÇK-së kanë mbajtur apo po mbajnë pozita të larta shtetërore, në Kosovë e në Serbi.

Të gjithëve u themi se luftëtarët e lirisë bënë luftë të pabarabartë, por fituan në fund. Ne kishim për barrë të krijonim ushtrinë tonë çlirimtare, të çlironim vendin, të krijonim shtetin, ta shpallnim të pavarur dhe ta bënim të njohur në botë. Të gjitha këto i bëmë bashkë edhe pse dikur pak kush besonte se kjo mund të bëhej ndonjëherë në jetë dhe na sulmonin pa mëshirë, para luftës, gjatë luftës, pas luftës dhe pas pavarësisë. Ushtria jonë çlirimtare njihet për pastërtinë maksimale në veprimet luftarake dhe në përputhje me Konventat e luftës. Për këtë ka arsye të mburret tërë kombi dhe miqtë tanë dhe jo të turpërohet për diçka.

U bëjmë thirrje krerëve shtetërorë t'i sqarojnë deklaratat e tyre, e posaçërisht konkretisht Albin Kurtit, sepse një spastrim i padrejtë tashmë është në vepër nga dora e tij dhe aleatëve të tij politikë.

Askush të mos testojë më tutje durimin e ushtarëve të lirisë!



Javën e ardhshme kryeministri Albin Kurti ka paralajmëruar takim me liderët e partive opozitare

PDK-ja refuzon ftesën e Kurtit, LDK-ja e AAK-ja shkojnë në takim

Subjektet opozitare kanë shprehur qëndrime të ndryshme në lidhje me ftesën e kryeministrit Albin Kurti për takim. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka refuzuar këtë takim, duke thënë se temat e propozuara për diskutim në takim janë përgjegjësi e qeverisë. Ndërsa përfaqësuesit e LDK-së dhe të AAK-së kanë bërë me dije se liderët e tyre do t'i përgjigjen pozitivisht ftesës së kryeministrit për takim që pritet të mbahet javën e ardhshme

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë për takime tre liderëve të subjekteve opozitare, por përgjigje pozitive ka marrë vetëm nga LDK-ja dhe AAK-ja. Partia më e madhe opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk do të shkojë në këtë takim. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të kësaj partie, Enver Hoxhaj, përmes një letre drejtuar kryeministrit Kurti, i ka treguar arsyet pse nuk do të marrë pjesë në takim.

Hoxhaj ka vlerësuar se çështjet e propozuara për diskutim nga Kurti, pas vizitës së tij në Bruksel, siç janë marrëdhëniet me Belgjikën, me institucionet e BE-së dhe me vendet e rajonit, duhet të trajtohen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës. "Këto janë përgjegjësi të qeverisë dhe nuk janë tema të cilat duhet t'i diskutoni në takime të mbyllura me liderët e partive opozitare. Nëse përmes formulimit 'çështje madhore' i jeni referuar ndonjë teme tjetër të rëndësishme, atëherë unë ju ftoj që të jeni më konkret dhe më transparent, në mënyrë që edhe qytetarët e vendit të jenë të mirinformuar. Ju duhet t'i emërtoni saktë temat me emrat e tyre. Për çfarëdo 'çështje

madhore' ju konfirmojmë gatishmërinë e Partisë Demokratike të Kosovës për të diskutuar hapur dhe në interes të qytetarëve dhe të shtetit në Kuvendin e Kosovës", ka shkruar Hoxhaj.

Ndryshe nga PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja do të shkojnë në takim me kryeministrit Albin Kurti.

Zëdhënësja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sibel Halimi, ka deklaruar se kjo parti është e përkushtuar që dialogu të përfundojë suksesshëm me njohje reciproke, andaj nuk i ik asnjë takimi. "Ashtu siç është deklaruar edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, parimisht, LDK nuk i ik asnjë takimi, prandaj do të marrë pjesë edhe në takimin e ftuar", është shprehur ajo për "Ekonomia Online".

Halimi ka thënë se LDK-ja do të ketë rol kontributdhënës në dialogun me Serbinë. "LDK-ja është e përkushtuar që dialogu të përfundojë suksesshëm me njohje reciproke, në kufijtë aktualë dhe në respektimin e parimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj, LDK-ja do ta luajë rolin e saj, duke dhënë kontribut në Kuvendin e Kosovës si parti opozitare. Ky rol i LDK-së karshi dialogut tanimë është i formësuar dhe do të prezantohet në secilin format të

takimeve", është shprehur Halimi

Edhe zëdhënësi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Lulëzim Blakaj, e ka konfirmuar pjesëmarrjen e Haradinajt në takim. "Kryetari Haradinaj do të takohet me kryeministrit Kurti në fillim të javës tjetër në orar të dakorduar bashkërisht", ka deklaruar Blakaj.

Ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, ka komentuar ftesën që kryeministri Albin Kurti ua ka bërë partive opozitare në Kosovë për të diskutuar për temat me rëndësi për vendin, siç është dialogu me Serbinë. Tahiri ka thënë se ftesa e Kurtit për bashkëpunim me opozitën për çështjen e dialogut është për t'u përshëndetur. Tahiri ia rikujtuar Kurtit kohën kur nuk ka bashkëpunuar me partitë në pushtet në kohën kur ishte në opozitë. "Stuhitë politike sprovojnë politikanët! Ftesa e kryeministrit Kurti për bashkëpunim me opozitën rreth dialogut është për t'u përshëndetur, pavarësisht se vetë nuk ka bashkëpunuar kur ishte në opozitë", ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në "Facebook".

Të enjten kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka dërguar ftesë për takime tre liderëve të subjekteve opozitare në Kuvendin e Kosovës, Enver Hoxhaj të Partisë Demokratike

të Kosovës (PDK), Lumir Abdixhiku të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Ramush Haradinajt të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Në njoftimin e zyrës së kryeministrit thuhet se takimet planifikohen të mbahen në javën e ardhshme dhe do të jenë në shërbim të bashkërendimit të spektrit politik për çështje me interes të Kosovës. Në njoftim nuk përmendet në mënyrë të veçantë çështja e dialogut me Serbinë, mirëpo Kurti disa herë ka theksuar se nuk do të zhvillojë takime në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja pa u konsultuar me spektrin politik në Kosovë.

Kryeministri Albin Kurti gjatë darkës së punës të udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bruksel më 18 maj, ka deklaruar se procesi i dialogut me Serbinë duhet të jetë parim dhe të përgatitet mirë. "Duam dialog të përgatitur mirë, parimor, si palë të barabarta, në të cilën, natyrisht, thelbi është ai që tashmë e ka thënë edhe presidenti i ri amerikan, Joe Biden, por edhe shumë liderë të tjerë botërorë, se zgjidhja e ka emrin në formën e togfjalëshit: njohja reciproke. Pra, as Serbia s'e njej Kosovën, por as Kosova s'e njej Serbinë dhe njohja reciproke është ajo që do të kontribuonte shumë për paqen, stabilitetin dhe sigurinë afatgjatë në Ballkan", ka thënë Kurti.

Në muajin qershor pritet të mbahet një takim në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Qeveria Kurti hesht lidhur me Manastirin e Deçanit

PRISHTINË, 21 MAJ - Qeveria e Kosovës qëndron e heshtur lidhur me kërkesën e shteteve të QUINT-it (Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Italia e Britania e Madhe) për respektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me tokën e Manastirit të Deçanit. Shefat e misionëve të këtyre shteteve të mërkurën (19 maj) përmes një komunikate të përbashkët kanë thënë se "Qeverisë së re të Kosovës iu dha një mandat i fuqishëm për reforma dhe respektim të sundimit të ligjit". Sipas tyre, provë kryesore e vendosmërisë së saj do të jetë zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës mbi regjistrimin e tokës së Manastirit të Deçanit. "E inkurajojmë atë (qeverinë) që pa vonesë vazhdon

procesin e regjistrimit të pronës së Manastirit të Deçanit në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese", thuhet në deklaratë. "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar kabinetin e kryeministrit Albin Kurti për të marrë një përgjigje lidhur me këtë çështje por, deri në publikimin e këtij teksti, nuk ka pranuar përgjigje. Gjithashtu, pyetje lidhur me këtë çështje "REL"-i ka dërguar edhe në Ministrinë e Kulturës të Kosovës, mirëpo zyrtarët thanë se me kohë do të përgjigjen. Herën e fundit që presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani - Sadriu dhe kryeministri Albin Kurti janë shprehur për çështjen e Manastirit të Deçanit është pasi organizata Europa Nostra e nominoi Manastirin e Deçanit në listën e

"Shtatë monumenteve më të rrezikuara". Në letrën që mban datën 18 mars, drejtuar krerëve të kësaj organizate, Kurti dhe Osmani thonë se "Manastiri i Deçanit është në gjendje të mirë, me garanca të plota kushtetuese e ligjore, me siguri të plotë e pa asnjë rrezik që i kanoset - është një nga monumentet me të cilat mburren shteti dhe shoqëria e Kosovës dhe, sikurse përgjatë historisë, ne do të vazhdojmë ta mbrojmë me shumë dashuri e përkushtim edhe në të ardhmen". "Të gjitha komunat e Kosovës, ku hyn edhe Komuna e Deçanit, janë duke i hartuar planet hapësinore dhe zhvillimore. Për informatën tuaj, Komuna e Deçanit është zotuar që brenda këtyre planeve zonën e veçantë të Manastirit të

Deçanit do ta trajtojë me prioritet të veçantë dhe seriozitet të shtuar. Ky trajtim nënkupton respektim të përpiktë të legjislacionit vendor, në veçanti të rregullave të mbrojtjes dhe menaxhimit të përcaktuara nga UNESCO", thuhet në letrën e Kurtit dhe Osmanit. Megjithatë, organizata Europa Nostra në fillim të muajit prill publikoi listën e "Shtatë monumenteve më të rrezikuara" dhe aty ishte përfshirë edhe Manastiri i Deçanit. Pesë vjet më parë Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka marrë vendim, sipas të cilit, i njihet e drejta e pronësisë Manastirit të Deçanit mbi 24 hektarë tokë. Por, ky vendim nuk është zbatuar asnjëherë nga institucionet e Kosovës, konkretisht komuna e Deçanit, pavarësisht prej

thirrjeve për një gjë të tillë nga komuniteti ndërkombëtar. Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se nuk do ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe rrjedhimisht pohoi se autoritetet komunale nuk kanë ndryshuar qëndrimin e tyre për të mos pranuar regjistrimin e pronës për Manastirin e Deçanit. Edhe Kryesia e Lidhjes e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" dega në Deçan ka kundërshtuar përsëritjen e kërkesës së vendeve të Quintit që të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Kryetari i shoqatës, Shkodran Imeraj, tha se në mënyrë antikushtetuese dhe antiligjore po përipiqen që Manastirit të Deçanit t'i falet tokë.



AGK dhe KE-ja mbajtën trajnimin "Raportimi i parregullsive nga sinjalizimi"

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, Zyra në Prishtinë, kanë mbajtur trajnimin "Raportimi i parregullsive përmes sinjalizimit", me studentët e fakulteteve të gazetarisë dhe drejtësisë të të gjitha universiteteve publike dhe private në Kosovë. Në këtë trajnim studentët janë trajnuar lidhur me mënyrën e funksionimit të sinjalizimit në fushën e gazetarisë. Ligjërata e udhëhequr nga trajnerja e KE-së, njëherësh eksperte e medias, Flutura Kusari, u fokusua në kuadrin e lirisë së shprehjes, me theks të veçantë në standardet e aplikuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë rast, trajnerja ka

prezantuar një mori shembujsh se si gjykata në fjalë ka vepruar kur mediat janë shërbyer me informata nga sinjalizuesit dhe që janë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu, Kusari u ka shpjeguar studentëve tiparet se si funksionon sinjalizimi dhe si të përdoret legjislacioni përkatës në shërbim të raportimit të parregullsive. Krahas kësaj, studentët u njohën edhe me raste konkrete të raportimit të parregullsive të cilat janë trajtuar nga mediat e Kosovës. Mimoza Koprani-Muçaj, ish-kryeredaktore e KTV-së, ilustroi përmes shembujve të ndryshëm lajme që për burim kanë pasur sinjalizuesit. Për më shumë, Koprani-Muçaj paraqiti mënyrat

që përdorin ata për ta bërë paraqitjen e parregullsive në media. Sipas saj, sinjalizuesit preferojnë t'i njoftojnë mediat përmes takimeve personale me gazetarët, duke shmangur kështu format e tjera të komunikimit. Organizimi i këtij trajnimi është bërë në kuadër të projektit Liria e Shprehjes dhe e Medies JUFREX2, i financuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, si dhe zbatuar nga AGK. Trajnimi ishte në vazhden e një serie trajnimesh dhe aktivitësh të parapara me këtë projekt për gazetarët, punonjësit e mediave, studentet dhe të tjerëve të interesuar në këtë fushë. Për shkak të gjendjes epidemiologjike të pandemisë Covid-19, takimi është zhvilluar online përmes platformës "Zoom".



SBASHK-u: Qeveria po i ik dialogut, do të përballlet me veprime sindikale

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

Prishtinë, 21 maj - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (SBASHK) ka njoftuar të premten se ka bërë përpjekje tani e sa kohë, duke dërguar shkresa zyrtare, që të takohet me kryeministrin Albin Kurti dhe me ministrin Hekuran Murati e ministren Arbërie Nagavci, me qëllim që të debatojnë për të gjithë çështjet e ngritura nga punëtorët e tërë sektorit të arsimit, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e pranueshme përmes dialogut të mirëfilltë. "Kujtojmë se qeveria, edhe përkundër agjendave të ngjeshura, duhet të gjejë kohë të takohet e t'i dëgjojë shqetësimet e punëtorëve të njërës prej sektorëve më të rëndësishëm dhe të SBASHK-ut si sindikata më e madhe numerikisht dhe më e fuqishmja për nga angazhimet dhe aktivitetet. Kryeministri Kurti dhe ministri

Murati nuk u janë përgjigjur kërkesave të SBASHK-ut për takime e për dialog e, kohën e fundit, sikur edhe ministrja Nagavci, po zgjedh të njëjtën mënyrë dhe merr vendime aty për aty, pa u konsultuar e pa pasur dialog me SBASHK-un si përfaqësuesin e vetëm të të punësuarve që nga çerdhjet e deri edhe në universitetet e Kosovës dhe në sektorin e kulturës", thuhet në komunikatën e SBASHK-ut. Sipas SBASHK-ut, kryeministri Kurti, ministri Murati dhe ministrja Nagavci duhet ta dinë se punëtorët e arsimit kanë ngritur shumë shqetësime dhe ato i kanë adresuar përmes përfaqësuesve të tyre në organet udhëheqëse të SBASHK-ut e të cilat janë të obliguara të angazhohen për gjetjen e zgjedhjes meritorë për to. "Do të ishte mirë që kjo të bëhet me dialog. SBASHK-u në kërkesat zyrtare drejtuar kryeministrit Kurti, ministrit Murati dhe ministres Nagavci u ka shpjeguar edhe për çështjet



që duhet të debatojnë sepse janë kërkesa të punëtorëve të arsimit e të kulturës. Mirëpo gatishmëria e qeverisë për takime e dialog deri tani ka munguar dhe nëse kryeministri Kurti, ministri Murati e, mbase, edhe ministrja Nagavci vazhdojnë të arsyetohen se

kanë agjenda të ngjeshura dhe u ikin takimeve e dialogut me SBASHK-un për çështjet dhe shqetësimet e ngritura nga punëtorët e sektorit të arsimit e kulturës, atëherë mund të vijë deri te kërkesa e anëtarësisë për veprime sindikale, duke nisur, mbase, me kundërshtimin për

zgjatjen e vitit shkollor dhe kërkesa të tjera, të cilat organet udhëheqëse të SBASHK-ut do t'i zbatojnë në përpikëri, por përgjegjësinë për gjendjen që do të krijohet do ta kenë ata që po u ikin takimeve dhe dialogut", është theksuar në komunikatën e SBASHK-ut.

Qeveria voton anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim



PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Me propozim të ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Arbërie Nagavci, qeveria ka votuar të premten për shtatë anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) apo bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA). Të gjithë këta do të procedohen për ratifikim në Kuvend. Katër prej të emëruarve janë vendorë dhe tre ndërkombëtarë. Vendimi është marrë bazuar në rekomandimet e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit të të

nominuarve dhe vetënominuuarve për anëtarë të KShC-së. MASHTI ka ndërmarrë të gjitha veprimet që procesi të jetë transparent. Komisioni vlerësues ka qenë i përbërë nga pesë anëtarë të nominuar nga institucionet dhe përfaqësuesit vendorë dhe ndërkombëtarë të shoqërisë civile. Procesi është monitoruar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN). MASHTI do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet që AKA të jetë e pavarur në punën dhe vendimet e saj, derisa pret që puna e tyre të realizohet me

profesionalizëm dhe integritet të lartë. Anëtarët e KShC-së zgjedhen me mandat të caktuar pesëvjeçar. Katër të emëruarit vendorë janë: Hasnija Ilazi, Gëzim Tosuni, Seb Bytyçi dhe Krenare Pireva-Nuçi. Ndërkaq, tre anëtarët ndërkombëtarë, Alison Felce, Cassie L. Bernhardt dhe Werner J. Stueber, janë emëruar në konsultim me partnerët ndërkombëtarë, respektivisht me ndihmën e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Ambasadës Britanike dhe Ambasadës Austriake, përkatësisht Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Sveçla takohet me homologun nga Shqipëria, temë diskutimi marrëveshja kufitare mes dy vendeve

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, bashkë me delegacionin që e shoqëronte, në përbërje të të cilit ishin zyrtarë të lartë të ministrisë e të Policisë së Kosovës dhe Doganës së Kosovës, zhvilloi dje një takim zyrtar me ministrin e Brendshëm të Shqipërisë, Bledi Çuçi. Të dy homologët diskutuan për funksionimin e marrëveshjes kufitare në mes dy vendeve, për mundësinë e rikategorizimit të pikës kufitare të Shishtavecit dhe çështje të tjera me interes të të dy

vendeve. Në këtë takim u bisedua edhe për shtimin e bashkëpunimit policor në luftën kundër krimit të organizuar, kontrabandës dhe trafikimit në të dyja anët e kufirit, si dhe për koordinimin për çështje të tjera që lidhen me procesin e integritet evropian të dy vendeve. Po ashtu, pjesë e diskutimit ishte edhe çështja e lehtësimit të mëtejshëm të lëvizjes së lirë të njerëzve, sidomos atyre që banojnë në brezin kufitar Shqipëri - Kosovë.



15 pacientë me Covid po trajtohen në Spitalin e Gjilanit, gjendja e tyre stabile

GJILAN, 21 MAJ (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, i udhëhequr nga nënkryetari Arbër Ismajli, ka mbajtur të premtën takimin e radhës për vlerësimin e situatës për këtë javë.

Nënkryetari Ismajli i ka falënderuar anëtarët e komitetit për angazhimin e jashtëzakonshëm në këtë proces si dhe punëtorët shëndetësorë të cilët tash e 15 muaj janë në luftë me të panjohurën.

Ismajli ka bërë me dije se aktualisht po trajtohen 15

pacientë në Spitalin e Përgjithshëm dhe, fatmirësisht, gjendja e tyre është stabile.

Në emër të komitetit Ismajli u ka bërë thirrje qytetarëve që të vazhdojnë t'i respektojnë masat deri në vaksinimin e plotë të popullatës.

Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 21 191 mostra, 6 401 kanë rezultuar pozitivë, 6 215 janë shëruar, 146 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 40 raste janë aktive dhe të shtrirë në spitale me Covid janë 15 persona.



Ish-presidentja Jahjaga viziton Kamenicën, interesohet për fuqizimin e të rinjve dhe grave

KAMENICË, 21 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me zyrtarë nga kabineti i tij, kanë pritur në takim ish-presidenten e Kosovës, Atifete Jahjaga, njëherësh edhe themeluese e organizatës "Fondacioni Jahjaga". Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me fuqizimin e të rinjve dhe grave.

I pari i komunës, Qëndron Kastrati, tha se ishte kënaqësi që ta mirëpresin në takim ish-presidenten Jahjaga. "Kisha kënaqësinë që me kolegë nga



kabineti të mirëpresim në Kamenicë ish-presidenten e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, njëherësh edhe themeluesen e organizatës 'Fondacioni Jahjaga', me të cilën bashkëpunojmë tash e sa kohë. Bashkërisht vizituam gjimnazin 'Ismail Qemali' në Kamenicë, si dhe Qendrën Rinore, ku të rinjtë tanë do ta kenë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të tyre. Fuqizimi i grave dhe të rinjve është një nga agjendat të cilën do ta shtyjme gjithmonë përpara", ka thënë Kastrati. Ndërsa ish-presidentja Atifete

Jahjaga gjatë vizitës te nxënësit e Kamenicës ndau përvojën e saj si presidente e parë grua në Kosovë. "Isha në vizitë në Gjimnazin 'Ismail Qemali' në Komunën e Kamenicës. Takova nxënësit e kësaj shkolle, me të cilët ndava përvojën time si presidentja e parë grua në Kosovë, duke përfshirë sfidat që kam hasur në atë kohë si dhe mësimet që kam nxjerrë nga ajo përvojë. Gjithashtu, nxënësve ua lashë mesazhin që asnjëherë të mos bëjnë kompromis me vlerat e tyre", ka thënë Jahjaga.

Fermerët e Zhupës në Prizren përfitojnë materiale për kultivimin e bimëve manore

PRIZREN, 21 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Caritasit zviceran, Gerhard Schaumberger dhe drejtoreshën e Zyrës Koordinuese për Bashkëpunim Zhvillimor të Austrisë në Prishtinë (ADA), Sandra Horina, kanë bërë shpërndarjen e materialeve për kultivimin e bimëve manore për fermerët e rajonit të Zhupës, që kanë përfituar nga projekti SIRE (Zhvillimi i

Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës Ekonomik Rural).

Në kuadër të këtij projekti, i cili është bashkëfinancim i Komunës së Prizrenit dhe Caritasit zviceran, gjithsej 14 fermerë të rajonit të Zhupës sivjet kanë përfituar materiale për kultivimin e bimëve manore, të cilët do t'i mbjellin në një hapësirë rreth 1.5 hektarë.

Me këtë rast kryetari Haskuka deklaroi se bimët manore

aktualisht janë një nga llojet e bimëve më të kërkuara nga tregu ndërkombëtar. Në këtë aspekt, ky projekt, përveçse do t'i rrisë të ardhurat e familjeve të fermerëve, po ashtu do të ndikojë edhe në zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Prizrenit.

Kryetari Haskuka ka falënderuar Caritasin zviceran dhe ADA-n për bashkëpunimin e tyre me Komunën e Prizrenit dhe për mbështetjen e fermerëve.



Agjencia për ndihmë juridike falas tash edhe në Podujevë



PODUJEVË, 21 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka zhvilluar takim me drejtoreshën e Agjencisë për Ndihmë Juridike, Anita Alaj-Kalanderi. Qëllimi i këtij takimi ishte që Agjencia për Ndihmë Juridike t'i ofrojë shërbimet e saj edhe në Komunën e Podujevës. "Gjatë këtij takimi tejet konstruktiv

jemi pajtuar në parim që kjo agjenci ta shtrijë veprimtarinë e saj edhe në komunën tonë. Ky bashkëpunim është në mes të Agjencisë për Ndihmë Juridike, Komunës së Podujevës dhe GIZ-it gjerman si bashkëfinancues. Ky është një lajm i mirë për qytetarët e komunës sonë, ku tash e tutje do ta kenë një

adresë ku mund të marrin shërbime juridike falas për t'i shfrytëzuar të drejtat e tyre", ka thënë Bulliqi.

Ai ka thënë se Komuna e Podujevës do t'i kryejë të gjitha obligimet që i takojnë. Ky projekt pritet të zbatohet nga muaji korrik dhe do të vendoset zyra për këshilla juridike falas për të gjithë qytetarët.

Filloi puna për hartimin e projektligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u mbajt takimi i parë i Grupit Punues për hartimin e projektligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme.

Në praninë e ministres së Drejtësisë, Albulena Haxhiu, dy zëvendësministrave, Blerim Sallahu dhe Nita Shala, si dhe anëtarëve të tjerë të kabinetit, kryesuesi i këtij takimi, Isuf Jahmurataj, u shprehu mirëseardhje anëtarëve të këtij grupi, duke u uruar mbarësi në vazhdimësi të punëve drejt hartimit të projektligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme. Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, shprehu falënderimet ndaj anëtarëve të grupit punues, gjegjësisht përfaqësuesve nga shoqëritë civile, institucionet relevante të drejtësisë dhe partnerëve strategjikë ndërkombëtarë për vullnetin që të kontribuojnë në këtë drejtim drejt forcimit të ligjit dhe drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Ministria Haxhiu, duke theksuar nevojën e

domosdoshme për hartimin e këtij projektligji, theksoi se tashmë jemi vonuar në drejtim të kompletimit të pakos ligjore kundër korrupsionit me qëllim të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sipas Ministres së Drejtësisë, ky rregullim nuk ka treguar apo dëshmuar sukses në luftimin e pasurimit të paligjshëm pasi që aktualisht, me legjislacionin në fuqi, në çdo rast kushtëzohet konfiskimi i pasurisë së përfituar përmes aktivitetit kriminal me zhvillimin e procedurës penale që ndërlihet me kryerjen e një veprë penale, gjë që paraqet pengesë juridike që krimi i organizuar të luftohet në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në fjalimin e saj, ministria Haxhiu u zotua personalisht që me të gjitha kapacitetet intelektuale dhe mekanizmat e Ministrisë së Drejtësisë do të jetë në përkushtim të plotë për ta jetësuar forcimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe inkurajoi anëtarët e grupit punues për angazhim të pakursyer në mënyrë që bashkërisht të konsiderojmë se



korniza ligjore duhet të jetë në shërbim të interesit të përgjithshëm shoqëror, me qëllim të mbrojtjes së vlerave shoqërore si dhe garantimin e sigurisë dhe rendit publik për shoqërinë dhe individin si një tërësi komplementare.

Po në këtë takim është bërë prezantimi i planit të punës nga Isuf Jahmurataj, kryesues i

grupit punues, i cili pritet të përfundojë brenda vitit.

Në anën tjetër të pranishmit në takim, përfaqësues nga institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, fillimisht u deklaruan për nevojën e bashkëpunimit dhe konsultimit për disa çështje kryesore si: organin kompetent për konfiskim, fushëveprimin e

ligjit e të tjerë, si dhe shprehën vullnetin dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në këtë proces të rëndësishëm reformues në sistemin e drejtësisë.

Në fund të takimit, anëtarët e grupit punues u pajtuan për planin e punës dhe për formatin mbi bazën e të cilit do të hartohet ky projektligj.

Qeveria emëron bordet e përkohshme të drejtorëve në katër ndërmarrje publike



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 MAJ - Qeveria e Kosovës ka emëruar të premtën bordet e përkohshme të drejtorëve në katër ndërmarrje publike. Bordi i përkohshëm i drejtorëve të ndërmarrjes publike "Trepça" Sh. A. ka këtë përbërje: 1. Bahri Hyseni, kryesues; 2. Hekuran Nikçi, anëtar; 3. Shyqri Kelmendi, anëtar; 4. Alban Krasniqi, anëtar; 5. Shyqri Sadiku, anëtar.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve

i ndërmarrjes "Korporata Energjetike e Kosovës/KEK" Sh. A: 1. Rrezarta Pllana, kryesues; 2. Bezat Halilaj, anëtar; 3. Merita Kasapollari, anëtar; 4. Arbnorë Pula, anëtar.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore "Posta e Kosovës" Sh. A: 1. Safije Beseni, kryesuese; 2. Sebahate Krasniqi, anëtar; 3. Genc Rama, anëtar; 4. Naim Haliti, anëtar.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore - Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës

"Infrakos" Sh. A: 1. Enis Berisha, kryesues; 2. Ardita Salihu, anëtar; 3. Fitnese Ismajli, anëtar; 4. Afrim Mehmetaj, anëtar.

Po në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të qeverisë për emërimin e anëtarëve të komisionit për kompensimin e viktimave të krimit.

Me ndryshimin dhe plotësimin e këtij vendimi, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, emërohet Sevdije Morina në vend të Arjana

Shajovcit, dhe, me propozimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, emërohet Blerta Deliu-Kodra në vend të ish-deputetes Donika Kada-Bujupi.

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, qeveria ka miratuar nismën për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, mbi lirinë e lëvizjes së qytetarëve

dhe palëve të treta dhe nisma për lidhjen e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes dhe qëndrimin të shtetasve të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe nisma për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare të partneritetit për "Menaxhimin e grant kontratës të asistencës teknike në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut nën IPA II (2014 - 2020)".

Kosova regjistron dy viktima dhe 58 të infektuar me Covid

PRISHTINË, 21 MAJ - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka regjistruar të premten dy viktima nga koronavirusi. "Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Mitrovicë 1 rast (73 vjeç), Prizren 1 rast (86 vjeç)", është thënë në njoftim. Sipas

këtij institucioni, në 24 orët e fundit janë regjistruar 58 raste të infektimit me këtë virus, pas testimit të 2 816 mostrave. IKShPK-ja ka njoftuar se më 21 maj janë shëruar 156 pacientë nga sëmundja Covid-19 që shkakton

koronavirusi, derisa raste aktive janë 3 840. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 107 178 pacientë me këtë virus. Prej tyre, 2 239 kanë vdekur.



Avokatura shtetërore fitoi 516 raste gjyqësore, buxheti përfitoi gati 13 milionë euro

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Lëvizja FOL, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë, ka publikuar të premten raportin "Efikasiteti i Avokaturës Shtetërore gjatë vitit 2020", i cili përfshinë të dhënat në lidhje me rëndësinë, funksionin dhe punën e institucionit të Avokaturës Shtetërore gjatë vitit 2020.

Mexhida Demolli-Nimani, drejtoreshë ekzekutive në Lëvizjen FOL, ka thënë se FOL-i me mbështetjen e Ambasadës Holandeze në Kosovë ka monitoruar punën e Avokaturës Shtetërore për vitin 2020. "Ky institucion ka një rëndësi të veçantë sepse mbron shtetin nga paditë e ndryshme që mund t'i ketë qoftë nga individë apo edhe nga kompani. Nga efikasiteti i punës së këtij institucioni mund të mbrohen miliona euro të buxhetit të shtetit, njësoj sikurse nga dësh-timi i tyre mund të humbin mil-

iona", ka thënë Demolli-Nimani.

Albana Hasani, hulumtuese në Lëvizjen FOL, ka deklaruar se gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 janë krijuar gjithsej 2 180 lëndë të reja në rastet ku palë kanë qenë institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore. Sipas saj, numri më i madh i këtyre lëndëve ishin nga procedura jokontestimore (708 lëndë), duke u pasuar nga lëndët e procedurës administrative (632 lëndë), nga procedura kontestimore (599 lëndë), lëndët e procedurës përmbartimore (174 lëndë) dhe, në fund, nga lëndët e procedurës penale (68 lëndë). "Nga aktgjykimet e marra në vitin 2020, Avokatura Shtetërore i kishte fituar 516 lëndë, 431 lëndë i kishte humbur, ndërsa 99 lëndë ishin kthyer në rigjykim, 25 lëndë në rishqyrtim dhe 98 lëndë në rivendosje. Nga këto përfaqësime, institucionet e



Republikës së Kosovës kishin fituar gjithsej 12.8 milionë euro. Ndërkaq shuma e paguar nga institucionet shtetërore palëve që kanë pasur sukses në kontestet gjyqësore në vitin 2020 ishte 3.5 milionë euro", ka thënë Hasani.

Ai ka rekomanduar që të rritet transparenca e Avokaturës Shtetërore në uebfaqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duke i paraqitur të gjitha informatat dhe dokumentet e karakterit publik, meqenëse ka mungesë të madhe të publikimit të tyre.

Sami Istrefi, Avokat i Përgjithshëm Shtetëror, ka thënë se, duke marrë parasysh rolin dhe funksionin që ka ky institucion, është mirë i mbuluar me akte ligjore dhe se prioritet ky institucion ka, të jetë sa më i hapur në punën që bën.

Drenasi fiton çmimin e parë për performancën më të mirë komunale



PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Komuna e Drenasit ka fituar çmimin e parë për performancën më të mirë komunale për vitin 2019, me 72 pikë. Vendi i dytë me performancën më të mirë ka dalë të jetë Komuna e Rahovecit me 68 pikë, kurse në vendin e tretë janë radhitur Komuna e Lipjanit me 65 pikë dhe ajo e Obiliqit. Kështu është bërë me dije me rastin e

ndarjes së grantit të performancës komunale për vitin fiskal 2021, ku 21 prej tyre kanë arritur të marrin grante, ndërsa 17 të tjera nuk kanë plotësuar kushtet.

Çmimin për komunën e parë e ndau kryeministri Albin Kurti, me ç'rast ka thënë se matja e performancës komunale është shumë e rëndësishme pasi që

rrit transparençën, lehtëson përpjekjen për arritjen e standardeve ligjore, nxit konkurrencën dhe bën që sjelljet e punonjësve për arritjen e faqeve të synuara. Gjëja themelore e modelit të menaxhimit të performancës, sipas Kurtit, është që matjet të jenë të sakta dhe reale. Ai ka thënë se qeverisja lokale paraqet vlerë të zhvillimit të qytetërimit.

Shënohet 109-vjetori i Kuvendit të Junikut

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në shënimin e 109-vjetorit të Kuvendit të Junikut. Në një fjalë rasti, presidentja Osmani ka theksuar se Kuvendi i Junikut paraqet platformë të pastër nacionale politike dhe ushtarake të luftës së armatosur për çlirim kombëtar dhe pavarësisë së Shqipërisë. "Kuvendi i Junikut paraqet platformë të fuqishme politike, ushtarake dhe kulturore për

jetësimin e shtetit të mosvarmë shqiptar", ka thënë Osmani. Sipas saj, ky Kuvend artikuloi qartë kërkesat legjitime të shqiptarëve për pavarësimin e vendit si dhe vulosi orientimin e shqiptarëve për aleancën tradicionale me Perëndimin.

Në këtë kontekst, presidentja Osmani ka potencuar se duhet të kujdesemi që trashëgimia politike e kuvendit, matura dhe vendosmëria e prijësve të tij për ta marrë në duar fatin e vendit dhe

për ta jetësuar vullnetin për liri, të jetë një lloj udhërrëfyese i vazhdueshëm. "Si presidente e vendit do të kujdesem fort që shtyllat e shtetësisë të forcohen, që kujtesa historike të ruhet e të kultivohet dhe që ngjarje të tilla, si Kuvendi i Junikut, ta marrin trajtimin e duhur shkencor dhe kulturor", ka thënë presidentja Osmani. Osmani me këtë rast ka bërë homazhe pranë lapidarit të heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të Junikut.






Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE





QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Dukagjini në finale të barazhit



PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Skuadra e Dukagjinit nga Klina e ka siguruar finalen e barazhit për inkuadrim në Superligë, pasi ka fituar në ndeshjen gjysmëfinale të barazhit ndaj Flamurtarit (2-1). Skuadra nga Klina ishte më e mirë se skuadra kryeqytetase në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas dhe arriti sukses duke e siguruar finalen e barazhit. Në minutën e 22-të Fatlum Gashi ka shënuar një gol të bukur nga

gjuajtja e lirë për rezultatin 1-0. Osmani lëshoi dy raste të tjera shënimi për Dukagjinit, në anën tjetër edhe Flamurtari pati rastet e veta të cilat nuk arriti t'i shfrytëzojë.

Pjesa e dytë ishte edhe më interesante dhe nuk munguan golat, por edhe kartonët e kuq. Në minutën e 73-të Dukagjini shënoi edhe golin e dytë nëpërmjet sulmuesit Labinot Osmani. Futbollisti i Dukagjinit, Rinor Kuqi, u

ndëshkua me karton të kuq dhe epërsinë numerike në fushë e shfrytëzoi Flamurtari që shënoi për 2-1 nëpërmjet Bashkim Shalës (83). Në minutat në vazhdim ndeshja ishte edhe më e tensionuar dhe gjyqtari shpërndau edhe dy karton të kuq, për secilën skuadër nga një. Rezultati mbeti i pandryshuar dhe Dukagjini e siguroi finalen e barazhit. Tash e pret skuadrën që përfundon në pozitën e tetë në Superligë.

SHKURT

Kosova, renditet në vendin e shtatë në Evropian

Përfaqësuesja e Kosovës në karate, konkurrenca e femrave, ka përfunduar në vendin e shtatë në ekipore të Kampionatit Evropian "Poreç 2021". Vashat e Kosovës shënuan dy fitore, ndaj Polonisë dhe Malit të Zi, për të arritur deri në çerekfinale, ku u mundën nga Franca. Kosova priste rastin që përmes repesazhit të kërkonte medaljen e bronzit, por humbja e Francës në gjysmëfinale, ua pamundësoi vazhdimin tutje. Vendi i shtatë nga 34 kombëtare pjesëmarrëse në ekipore vlerësohet sukses për Kosovën. Kampionatin nga afër po e ndjek edhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi.

Tri klube në garë për Shaqirin

Aventura e Xherdan Shaqirit në Liverpool pritet të marrë fund gjatë verës. Anësori nga Gjilani pritet të largohet nga "Anfield Road" pas tri vjetësh qëndrimi. Mediet britanike raportojnë se Shaqiri është në shënjestër të disa klubeve të njohura si Sevilla, Lazio dhe Roma. Shaqiri që ka kontratë me Liverpoolin edhe dy vjet dhe "Reds" nuk janë të interesuar që ta huazojnë, por vetëm ta shesin. Shaqiri ka luajtur për Bayern Munchen, Inter, Stoke City dhe Basel.

Xhiroja vendos për Evropë, rënie nga Superliga dhe barazh

Prishtinë, 21 maj - Nesër (e diel) do të zhvillohet xhiroja e fundit e sezonit në Superligën e Kosovës në futboll derisa do të vendoset për skuadra që shkon në Evropë, ajo që bie nga elita dhe skuadra që do të luajë në barazh. Titulli i kampionit është vendosur në xhiron e parafundit ku Prishtina e ka rikthyer pas tetë vjetësh trofeun më të çmuar në futbollin vendor. Drita dhe Ballkani kanë dy pikë diferencë dhe të dyja synojnë që të dalin në Evropë. Drita luan ndaj Arbërisë në Gjilan, kurse Ballkani i shkon Prishtinës në stadiumin "Fadil Vokrri". Për mbijetesë dhe barazh në garë janë Arbëria, Feronikeli, Drenica dhe Llapi. Në xhiron e fundit takohen: Prishtina-Ballkani, Drita-Arbëria, Llapi-Feronikeli, Trepça '89-Drenica, Besa-Gjilani, derisa të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 15:00.



Trajner i Llapit: Familja Batatina ka dhënë deri në 2.5 milionë euro për klubin

Familja Batatina tashmë njihet që investimin që ka bërë te klubi i Llapit. Shifrat e investuara nga kjo familje tashmë kapin vlerën e 2.5 milionë eurove. Kështu të paktën ka deklaruar trajneri i kësaj skuadre, Tahir Batatina, i cili ka deklaruar se trofeu i arritur i kalon të gjitha. "Prej se e kemi marrë KF Llapin e deri më sot, familja ime Batatina ka shpenzuar mbi 2.5 milionë euro. Por trofeu që e kemi sjellur për herë të parë në Llap i kalon të gjitha. Ky është pasioni për futbollin dhe dashuria për qytetin tim", ka thënë Batatina në emisionin "Direkt" në ATV. Ndryshe Llapi ka fituar Kupën e Kosovës ditë më parë, derisa e ka mposhtur në finale skuadrën e Dukagjinit pas ekzekutimit të penaltive.

Flick: Marrëveshja me Gjermaninë? Kanë mbetur vetëm disa detaje

Munchen, 21 maj - Trajneri aktual i Bayern Munchenit, Hansi Flick, në konferencën e fundit për shtyp ka konfirmuar se është i gatshëm të drejtojë Kombëtaren e Gjermanisë.

Joachim Low ka dhënë njoftimin se Kampionati Evropian do të jetë hera e fundit kur ai do të jetë në krye të Gjermanisë. Zëvendësues i tij pritet të jetë trajneri i Bayernit, Hansi

Flick, madje ky i fundit ka konfirmuar se ekziston një marrëveshje verbale mbi këtë aspekt. "Po, unë kam biseduar me Federatën Gjermane të Futbollit. Të gjithë e dinë se si ndihem për

ekipin kombëtar. Bëhet fjalë për gjëra të vogla. Atëherë ne mund ta zyrtarizojmë vendimin", ka thënë Flick, i cili edicionin e kaluar ka fituar të gjithë trofetë e mundshëm me Bayernin.



Gjashtë normat olimpike 'Tokio 2020'

PRISHTINË, 21 MAJ - Kur kanë mbetur pak më shumë se dy muaj deri në hapjen e Lojërave Olimpikë "Tokio 2020", Komiteti Olimpik i Kosovës ka të siguruara gjashtë norma olimpikë, shkruan Komiteti Olimpik i Kosovës. Pesë norma janë nga sporti i xhudos dhe një nga mundja. Xhudistët, të prirë nga kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi (-52 kg), pastaj Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Loriana Kuka dhe Akil Gjakova, me pikët e fituara, kanë të siguruara normat dhe vetëm pritet konfirmimi zyrtar i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos. Normën e ka edhe mundësi Egzon Shala, kategoria deri në 125 kilogramë. Pritjet e presidentit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, për të fituar normën olimpikë janë edhe nga sporti i karatesë, boksit e notit, ku muaji qershor pritet të jetë përcaktues. KOK-u i ka të siguruara edhe tri ftesa të



univerzalitetit, me ç'rast dy do të jenë për notin dhe një për atletikën. Gjasat për një ftesë janë edhe nga Komisioni trepalësh në përbërje: Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON/IOC), Asociacioni i Komiteteve Olimpikë Kombëtare (ANOC), Asociacioni i Federatave Ndërkombëtare të Sporteve Verore (ASOIF). Lojërat e shtyra olimpikë "Tokio 2020" për shkak të pandemisë COVID-19 mbahen prej 23 korrik - 8 gusht 2021 në Tokio të Japonisë.

GJASHTË NORMAT OLIMPIKE TOKIO 2020:

Majlinda Kelmendi (xhudo)
Distria Krasniqi (xhudo)
Nora Gjakova (xhudo)
Loriana Kuka (xhudo)
Akil Gjakova (xhudo)
Egzon Shala (mundje)

Tri ftesa të univerzalitetit

2 - not
1 - atletikë

Washington siguron pjesëmarrjen në 'play-off'

WASHINGTON, 21 MAJ - Kompletetohet kuadri i tetë skuadrave që do të rivalizojnë njëra-tjetrën në fazën "play-off" në Konferencën e Lindjes në NBA. Washington Wizards arriti të sigurote pjesëmarrjen në fazën finale të "play-off"-it pasi e mposhti Indiana Pacers me rezultatin 142-115 në "Capital One Arena" në kryeqytet duke siguruar kështu biletën e fundit për në "play-off", si skuadra e pozicionuar në vendin e tetë. Në fazën paraeliminatore të "play-off"-it skuadra kryeqytetase fillimisht humbi mundësinë për t'u pozicionuar si skuadra e renditur në vendin e shtatë në sezonin e rregullt pasi u mposht nga Boston Celtics, megjithatë Wizards shfrytëzuan maksimalisht mundësinë e dytë që patën duke dominuar me lojë dhe rezultat ndaj Indiana Pacers që për të mbërritur deri këtu kishte mposhtur lehtësisht Charlotte



Hornets në raundin paraardhës. Në çerekfinalët e Lindjes Bradley Beal dhe Russell Westbrook me shokë do të kenë përballë skuadrën më të mirë të sezonit të rregullt në këtë Konferencë Philadelphia 76ers. Ndashja ndaj Pacers ishte e ekuilibruar vetëm në periodën e parë sepse më pas gjithçka u dominua nga Wizards që e mbyllën pjesën e parë në

avantazhin e 14 pikëve ndërkohë që në fraksionin e dytë thelluan epërsinë deri në 27 pikë për suksesin final 142-115. Më i miri mbi parket për skuadrën kryeqytetase ishte Bradley Beal i cili spikati me 25 pikë 5 rebound dhe 4 asistime, ndërkohë që Russell Westbrook iu afrua një tjetër triple-double me 18 pikë 8 rikuperime poshtë tabelës dhe 15 pasime vendimtare.

'AS': Mbappe dëshiron t'i bashkohet Realit

Kylian Mbappe ende nuk ka pranuar ofertën e PSG-së për të rinovuar kontratën. Ky hezitim nga ana e sulmuesit francez lidhet vetëm me një fakt, dëshirën e tij për tu transferuar në Madrid. Mbappe nuk e ka fshehur kurrë dëshirën e tij për të bashkëpunuar me

Zinedine Zidane por e ardhmja e trajnerit nuk është aspak e sigurt, përkundrazi, në Spanjë flasin për një divorc të sigurt në fund të këtij sezoni. Pavarësisht kësaj, Mbappe vijon të joshet nga ideja për të veshur fanellën e bardhë. Sipas të përditshmes sportive

"AS", Mbappe mbetet objektivi kryesor i Real Madrid, me apo pa Zidane në stol. Gjithnjë sipas "AS", presidenti Perez ka bindur francezin për tu transferuar tek Realit, edhe vetë sulmuesi nuk ka shumë pretendime se kush do të jetë trajneri i ri i Realit, është i gatshëm të bashkëpunojë

si me Allegri ashtu edhe me Raul, dy opsionet kryesore. Më shumë se emri i trajnerit të ri, Mbappe është bindur nga projekti i presidentit, sigurisht dhe nga ideja që në Madrid do ta ketë më të lehtë të fitojë Ligën e Kampionëve apo trofeun e "Topit të Artë".

SHKURT

Federer: Ja pse vendosa të luaj në Roland Garros

Pas dy vitesh, Roger Federer do të rikthehet të luajë në grand slam të Roland Garros, që nis më 30 maj në Paris. Ish-numri 1 në botë nuk është në formën optimale dhe këtë gjë e konfirmojnë rezultatet. Ai u mund që në ndeshjen e parë në turneun e fushave me dhe në Gjenevë, duke pasur shumë luhajtje në lojën e tij. Ndaj, nga zvicerani, nuk pritet shumë në turneun parisien. "Vendimi për të luajtur në Roland Garros kishte si objektivi të vetëm mundësinë që të rinis nga e para gjithçka. Ndashjet që do të luaj aty do të jenë si një lloj stërvitje e privilegjuar. Nuk pres rezultate shumë të larta aty. Jam i lumtur që rikthehem të luaj sërish dhe nuk kam më nevojë për rehabilitim. Turneu i Gjenevës më tregoi se duhet të bëj sërish disa sistemime në lojën time", ka thënë Federer.

Monza interesohet për Buffonin

Tashmë është edhe zyrtare që Gianluigi Buffon do të largohet nga Juventus në fund të këtij edicioni. Portieri legjendar e ka konfirmuar largimin, ndërsa ka thënë se mbetet të shihet nëse do të pensionohet apo do të ketë ndonjë ofertë që ia vlen. Ekipi nga Serie B, Monza raportohet se e ka kontaktuar portierin 43-vjeçar. Monza nuk arriti të inkuadrohej në Serie A, duke u eliminuar në "play-off" nga Cittadella. Shefi i Monzas, Galliani e ka kontaktuar portierin italian, megjithatë tani për tani nuk ka asnjë ofertë reale me shifra që lidhen me vitet e kontratës.

Boateng: Krenar që shkrova historinë me Bayernin

Mbrojtësi Jerome Boateng sot (e shtunë) e zhvillon ndeshjen e fundit për Bayern Munchen, kur kampionët e Gjermanisë e presin Augsburgun. Mbrojtësi ndodhet në vitin e fundit të kontratës, akordi i rinovimit nuk u gjet dhe palët do të ndahen pas 10 viteve, periudhë gjatë së cilës lojtari fitoi 22 trofe. Aventurë fantastike për 32-vjeçarin e lindur në Berlin. "Ndihem jashtëzakonisht krenar që jam bërë pjesë e historisë së këtij klubi, që kam në gjendje të luaj kaq shumë ndeshje dhe të argëtohem me fanellën e Bayernit. E dija që herët apo vonë do të mbaronte, sepse unë jam një person që ka nevojë për sfida të reja. Dua të përjetoj gjëra të tjera. I jam mirënjohës klubit dhe çdo personi që me të cilin kam punuar këto dhjetë vite, ka qenë realisht një eksperiencë e pabesueshme", ka thënë Boateng.

Zidane paralajmëron largimin: Realit ekip më i mirë pa mua

Trajneri i Real Madrid, Zinedine Zidane në konferencën për shtyp nga prag të sfidës së fundit në La Liga kundër Villarreal, u shpreh se madrilenët janë një ekip më i mirë pa të duke dhënë një sinjal të qartë lamtumire. "Nuk ka rëndësi nëse do të jem vitin e ardhshëm, fokusi qëndron vetëm tek ndeshja e cila do të tregojë nëse ishte një sezon për notë 9.5 apo për 10. Nuk është koha për të folur për të ardhmen, nuk do t'i përgjigjem pyetjeve të tilla. Realit më i mirë pa mua? Po, sigurisht. Unë kam qenë këtu për 20 vite dhe është gjëja më e mirë që më ka ndodhur. Jam me fat që jam në këtë klub të shkëlqyeshëm", ka thënë Zidane.



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Judicial Open Data Consultant
Procurement Ref. Number	IC/ MFK/2021/009
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Services
Employer	Millennium Foundation Kosovo (MFK)
Publication Date	21 May 2021
Submission Deadline	03 June 2021; 16:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo (MFK), has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The MFK, the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for selection of an individual consultant for Judicial Open Data Consultant.

The main objective of this assignment is to (1) clean and structure the datasets from private/public entities of the judicial sector in Kosovo in open data readable formats such as XLS or CSV, in accordance with the needs of these entities, (2) develop and deliver the data portion of the Judicial Dig Data Stakeholders Workshop, (3) develop a manual/guidebook for Judicial Dig Data Challenge, (4) develop a data analysis illustration to be used in the application form of the Judicial Dig Data Challenge.

A primary focus of this assignment is to build an open machine-readable database of the data available in the judicial sector, from entities that collect and generate analysis on this data, in order for civil society, the private sector, individuals and other related stakeholders to obtain and analyze this data.

MCC's funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the Threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MFK, money is already available to the MFK and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now invites Individual Consultant to provide the consultant services referenced above ("Proposals"). More details on these consultant services are provided in the Terms of Reference.

This LOI is open to all eligible entities ("Individual Consultant") who wish to respond. Subject to restrictions noted in the LOI.

A Consultant will be selected under the Individual Consultant Selection (IC), the evaluation procedure for which is described in sections of the LOI in accordance with "MCC Program Procurement Guidelines" which are provided on the MCC website (www.mcc.gov/ppg). The selection process, as described, will include a review and verification of qualifications and past performance, including a reference check, prior to the contract award.

A complete set of Letter for Invitation (LOI) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible consultants:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/judicial-open-data-consultant-ic-mfk-2021-009>

Consultants interested in submitting a proposal should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the LOI to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the consultants.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in LOI rejection. The File link for submission of qualifications is included in the LOI document.

Applications shall be submitted ONLY to the file request link provided in LOI documents no later than **03 June 2021; 16:00pm (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address referred to above is:	Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. "Migjeni" no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	www.millenniumkosovo.org



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejepuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Mehmet Temaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.
- ▶ Enver Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

